



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Datë: 03 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 26 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 12, 14, 16 dhe nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit si dhe Vendimin KPK/Nr.563/2024, të datës 28 maj 2024, shpall:

**SHPALLJE E BRENDSHME**

**Për plotësim me gjashtë (6) pozita për prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.**

- I. Prokurorët e Shtetit duhet t'i plotësojnë kriteret për avancim në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si në vijim:
- Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - Të ketë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë.
  - Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr.12/2015 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në Vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr.05/2020 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të Shtetit;
  - Të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore në pesë (5) vitet e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
  - Të mos ketë filluar hetimi penal;
  - Të ketë reputacion të lartë profesional;
  - Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimi në akademi apo nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekiye hetuese.

- II. Përveç kriterëve të përgjithshme kandidatët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë edhe kriteret e veçanta si në vijim:
- Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror dhe vlerësim pozitiv të performancës.
- III. Kandidati që aplikon për avancim duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
- Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre (3) vitet e fundit;
  - Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
  - Dokumentet apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.
- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 04 qershor 2024 deri më 18 qershor 2024.
- VI. Kërkesa duhet të dorëzohet tek Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e gjashtë (6), ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, Rruga " Luan Haradinaj", Prishtinë, zyra numër 602, të mbyllura me zarf ose me postë.

---

<sup>1</sup> Prokurorët të cilët aplikojnë për transferim dhe avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit, të cilin mund ta gjejnë likun <https://www.prokuroria->